



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12/2019 (JR)  
Nr. 12/2 regj.

Tiranë më 06.12.2019

**SHPALLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e **mërkurë, datë 08.01.2020, ora 10:00**, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike çështja me nr. regjistri (JR) 12/2019, datë 22.02.2019, për ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 84 datë 27.11.2018 që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani.

Seanca publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.  
Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesuese:</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>
<b>Relator:</b>	<b>Ardian Hajdari</b>
<b>Anëtare:</b>	<b>Albana Shtylla</b>
<b>Anëtar</b>	<b>Luan Daci</b>
<b>Anëtar</b>	<b>Sokol Çomo</b>

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**RELATOR I ÇËSHTJES**  
**GJYQTAR**  
**Ardian HAJDARI**

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**  
**Rezarta SCHUETZ**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, [www.kpa.al](http://www.kpa.al), e-mail: [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al)

